

Ngjitës elastik me 2 përbërës për pllakat

Përshkrimi

ISOMAT AK-ELASTIC është një ngjitës elastik me 2 përbërës për pllakat. Përbëhet nga një llaç pluhur me bazë çimentoje (përbërësi A) dhe një emulsion rrëshire (përbërësi B). Ofron një forcë ngjitëse fillestare dhe përfundimtare të lartë, elasticitet të shkëlqyer, si dhe rezistencë ndaj lagështirës. Ka kohë të mëdha të mbajtjes hapur për përdorim. Klasifikohet si ngjitës e llojit C2 E S2 sipas standardit EN 12004 dhe EN 12002.

Fushat e përdorimit

ISOMAT AK-ELASTIC është i përshtatshëm për ngjitjen e pllakave qeramike ose të gurëve natyralë mbi mure ose dysheme, mbi sipërfaqe që janë të paqëndrueshme ose që dridhen, si pllakat e gipsit, pllakat e zdrukthit, dyshemetë me ngrohje nga poshtë, tarracat, ballkonet, pishinat etj. Është gjithashtu i përshtatshëm për ngjitjen e pllakave të mëdha, si dhe për shtrimin e pllakave të reja mbi shtresat e pllakave të vjetra. Përshtatet për përdorim në mjedise të brendshme ose të jashtme. I përdorur në kombinim me llaçin lyster hidroizolues me 2 përbërës AQUAMAT-FLEX dhe AQUAMAT-ELASTIC, ofron një sistem perfekt për izolim dhe ngjitje.

Të dhënat teknike

	<u>Përbërësi A</u>	<u>Përbërësi B</u>
Baza:	pluhur çimentoje	pezulli ujore e polimerit akrilik
Ngjyra:	e bardhë	e
Raporti i përzierjes:	2,5 pjesë sipas peshës	1 pjesë sipas peshës

Produkti i kombinuar

Temperatura e përdorimit: nga +5°C deri në +35°C

Trashësia e përdorimit: deri në 10 mm

Koha e punueshmërisë: të paktën 8 orë

Koha e mbajtjes hapur: të paktën 30 minuta

Koha e mbajtjes hapur për riparime të vogla: të paktën 30 minuta

Stukimi i fugave në mure: pas 6-12 orësh

Stukimi i fugave në dysheme: pas 24-48 orësh

Forca ngjitëse pas:

- 28 ditësh: $\geq 2,00 \text{ N/mm}^2$
- ngrohjes në +70°C: $\geq 2,00 \text{ N/mm}^2$
- zhytjes në ujë: $\geq 1,50 \text{ N/mm}^2$
- 25 ciklesh ngrirje-shkrirje: $\geq 1,50 \text{ N/mm}^2$

Rezistenca ndaj temperaturave: nga -30°C deri në +90°C

Aftësia e deformimit sipas standardit EN 12002: > 5 mm

Të gjitha matjet janë kryer sipas standardit EN 12004.

Udhëzimet e përdorimit

1. Nënshtrësia

Sipërfaqja që do të mbulohet duhet të jetë e pastër, pa pluhur, graso, bojë, materiale të lira etj. Rekomandohet njomja e sipërfaqes përpara përdorimit.

2. Përdorimi

Përmbajtja e një thesi 25 kg (përbërësi A) hidhet në 10 kg lëng (përbërësi B) duke u trazuar vazhdimisht, derisa të krijohet një material homogjen në trajtë brumi. Për përzierjen rekomandohet përdorimi i një mikseri me xhiro të ulëta.

Përzierja duhet të lihet rreth 10 minuta të stabilizohet dhe pastaj duhet të trazohet përsëri me ngadalë.

Ngjitësi i pllakave duhet të shpërndahet dhe të "krihet" mbi sipërfaqe duke përdorur një mallë të dhëmbëzuar, me qëllim që të aplikohet në mënyrë uniforme në të gjithë sipërfaqen. Pas kësaj, pllakat duhet të fiksohen duke u ngjeshur në pozicionin e dëshiruar.

Përzjerja e shpërndarë duhet të mbulohet me pllaka brenda 30 minutash me qëllim që të evitohet formimi i "cipës", d.m.th. përpara se shtresa e ngjitëses të fillojë të mpikset.

Konsumi

1,5-4,0 kg/m², në varësi të madhësisë së dhëmbëve të mallës dhe të natyrës së nënshtresës.

Amballazhimi

- Paketim i kombinuar 35 kg (thes 25 kg llaç çimentoje pluhur + bidon plastik 10 kg me rrëshirë emulsioni).
- Paketim i kombinuar 7 kg (thes 5 kg llaç çimentoje pluhur + bidon plastik 2 kg me rrëshirë emulsioni).

Magazini

Afati i ruajtjes për përdorim, në pako të izoluara dhe në ambiente të thata dhe pa ngrica, është minimumi 12 muaj.

Shënime

- Përbërësi A i ISOMAT AK-ELASTIC përmban çimento dhe reagon si alkaline me ujin, kështu që klasifikohet si irritues.
- Sipërfaqet shumë poroze, si p.sh betoni i lehtë, pllakat e gipsit, pllakat e zdrukthit etj. duhet të lyhen fillimisht me astarin akrilik UNI-PRIMER.
- Në rast se ISOMAT AK-ELASTIC përdoret për ngjitjen e pllakave pa thithshmëri mbi sipërfaqe pa thithshmëri, koha e mpiksjes të ngjitësit mund të zgjatet.
- Shikoni rreziqet e përdorimit dhe këshillat për sigurinë që janë të shkruara mbi thes.



08

ISOMAT S.A.
17th km Thessaloniki – Ag. Athanasios
P.O. BOX 1043, 570 03 Ag Athanasios,
Greece

EN 12004

Ngjitës prej çimentoje, i përmirësuar, shumë i deformueshëm, për shtrimin e pllakave, me kohë të madhe të mbajtjes hapur

- | | |
|--|-----------------------|
| - Reagimi ndaj zjarrit | Klasi E |
| - Forca ngjitëse fillestare në tërheqje | ≥ 1 N/mm ² |
| - Rezistenca në tërheqje e ngjitjes pas (veprimit ose vjetërimit) termik | ≥ 1 N/mm ² |
| - Rezistenca në tërheqje e ngjitjes pas ngopjes me ujë | ≥ 1 N/mm ² |
| - Rezistenca në tërheqje e ngjitjes pas cikleve të ngrirjes-shkrirjes | ≥ 1 N/mm ² |

ISOMAT S.A.
BUILDING CHEMICALS AND MORTARS
ZYRAT QENDRORE – FABRIKA:
17th km Thessaloniki - Ag. Athanasios Road,
P.O. BOX 1043, 570 03 Ag. Athanasios, Greece,
Tel.: +30 2310 576 000, Faks: +30 2310 722 475
www.isomat.eu e-mail: info@isomat.eu

Informacioni teknik dhe udhëzimet e dhëna në këtë fletë të dhënash bazohen në njohurinë dhe në përvojën e Departamentit të Kërkimit dhe të Zhvillimit të kompanisë sonë dhe në rezultatet e dalta nga përdorimet afatgjata të produktit në praktikë. Rekomandimet dhe sugjerimet që i referohen përdorimit të produktit jepen pa garanci, meqenëse kushtet e terraveve gjatë përdorimeve të tij janë përtej mundësisë së kontrollit të kompanisë sonë. Si rrjedhojë, përdoruesi është përgjegjës për të konfirmuar se produkti i zgjedhur është i përshtatshëm për përdorimin e parashikuar. Botimi aktual i kësaj flete të dhënash teknike anulon automatikisht çdo botim të kaluar që lidhet me të njëjtin produkt.

